

Shqipëri-Kosovë: Si të përparojmë më tej?



10 Vite Marrëdhënie tregtare Shqipëri – Kosovë: Situata, Potenciali, Problematikat dhe disa sugjerime

Cilët janë faktorët që pengojnë rritjen edhe më të

vrullshme të tregtisë mes Shqipërisë dhe Kosovës? Si shpjegohet që megjithëse pjesë të të njëjtit komb, gjeografikisht afër, me infrastrukturë lidhëse të përmirësuar veçanërisht pas investimit madhor e hapjes së Rrugës së Kombit që padyshim ndihmon tregtinë, me pengesa tregtare të reduktuara në vazhdimësi, me vullnet të përbashkët e të padiskutueshëm politik e shtetëror midis dy vendeve për të thelluar bashkëpunimin ekonomik, ende marrëdhëniet tregtare me Kosovën përbëjnë një pjesë tepër të vogël të tregtisë së jashtme të Shqipërisë?

Nga Ilir Ciko*

Përgjatë muajve të fundit janë hedhur një sërë propozimesh mbi modelet e mundshme të thellimit të bashkëpunimit ekonomik e tregtar mes vendeve të Ballkanit, ndër të cilat si më i përmendur në nivelet politike, është krijimi i një bashkimi doganor, një model i përdorur me sukses në Traktatin e Romës, që hodhi themelet e Komunitetit Ekonomik Europian që ishte bërthama e Bashkimit Europian të sotëm. Ndonëse bashkimi doganor është një formë e njohur integrimi ekonomik, e përdorur edhe në raste të tjera veçmas atij të Bashkimit Europian, përpara angazhimit të mundshëm në një proces të tillë, vlen të analizohen me vëmendje kostot dhe përfitimet që mund të burojnë prej tij.

Si në çdo rast tjetër të analizës së modeleve ekonomike, parashikimi për

ç'mund të ndodhë në të ardhmen me një rajon që kërkon të thellojë integrimin ekonomik e tregtar, është jo vetëm i vështirë, por njëkohësisht edhe i ndërvarur nga faktorë të tjerë të jashtëm, të cilët mund të rezultojnë edhe më të rëndësishëm se modeli i zgjedhur i integritit. Ndaj në mungesë të garancive mbi qëndrueshmërinë e këtyre faktorëve, mënyra më e drejtpërdrejtë për të menduar mbi të ardhmen mbetet analiza dhe kuptimi i asaj ç'ka ndodhur gjatë viteve të fundit me këtë proces integrimi të nisur në rajon që prej thuajse njëzet vitesh, pavarësisht se historia jo gjithnjë është treguesi më i mirë i së ardhmes.

Viti 2016 shënoi plotësimin e një dekade të funksionimit të marrëveshjes së tregtisë së lirë CEFTA midis vendeve të rajonit të Europës Juglindore, që vijoi procesin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar midis vendeve, nisur në fund të viteve 90' dhe konkretizuar në marrëveshje bilaterale bashkëpunimi dhe tregtie të lirë. Kosova dhe Shqipëria janë pjesë e rëndësishme dhe aktive e këtij procesi, duke kontribuar pozitivisht në drejtim të suksesit të tij. Plotësimi i harkut kohor dhjetëvjeçar në historinë e bashkëpunimit mes vendeve të rajonit është një rast i mirë për analizimin, reflektimin dhe nxjerrjen e mësimëve mbi arritjet, por pse jo dhe mbi sfidat dhe dështimet e mundshme, bazuar në rezultatet dhe objektivat parësorë të tij.

Në funksion të synimit kryesor të marrëveshjes CEFTA, nxitjes së tregtisë e bashkëpunimit ekonomik midis vendeve dhe përgatitjes së tyre për të qenë anëtarë të Bashkimit European, progresi ka qenë i padiskutueshëm. Shifrat e rritjes së tregtisë me vendet e rajonit kanë qenë të larta për thuajse të gjitha vendet pjesëmarrëse në CEFTA, e madje në shumë raste, përfshirë Shqipërinë, edhe më të larta se rritja mesatare e tregtisë për këto vende, duke na paraqitur një ilustrim të qartë të rolit dhe funksionimit të një marrëveshjeje tregtare preferenciale. Dy vende themeluese të CEFTA 2006 – Bullgaria dhe Rumania – dolën nga marrëveshja ende pa nisur funksionimi i saj, për shkak të pranimit të tyre me të drejta të plota si anëtarë të Bashkimit European, dhe të njëjtën rrugë ndoqi edhe Kroacia në vitin 2013. Vendet e tjera të rajonit kanë kryer gjithashtu përparim në shkallë të ndryshme drejt afrimit me Bashkimin European, ndonëse mjaft punë mbetet ende për t'u kryer deri në arritjen e këtij objekti i cili mbetet

i papërcaktuar në kohë.

Nuk duhet mohuar fakti që përveç arritjeve në drejtim të nxitjes së aktivitetit tregtar, mes vendeve të rajonit, jo rrallë gjatë këtyre viteve janë shfaqur edhe pakënaqësi, konflikte dhe përfitime të pabalancuara prej funksionimit të CEFTA-s, të cilat lidhen jo vetëm me faktorët e orientimit të tregtisë por edhe me shkallën e pabarabartë të zhvillimit të sektorëve ekonomikë të vendeve, mundësitë e kufizuara të ofertës në këto vende, qasjen mbrojtëse ndaj aktiviteteve vendase, orientimit të tregtisë drejt partnerëve jashtë zonës së CEFTA-s, klimës politike brenda dhe mes vendeve të rajonit, efekteve të krizës globale dhe kërkesës e rritjes së dobët ekonomike në vendet e rajonit dhe tregjet globale, apo lidhur me këto të fundit, mungesës së investimeve të huaja, e veçanërisht atyre rajonale, aq të shumëpritura në kuadër të funksionimit të CEFTA-s.

Synimi kryesor i këtij punimi është paraqitja e përmbledhur e faktorëve të mësipërm, duke u fokusuar në marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës, përgjatë shtrirjes në kohë të CEFTA-s në periudhën 2006-2016. Këtu vlen të theksohet një faktor i rëndësishëm. Tregtia e jashtme e Shqipërisë, gjatë dy-tre viteve të fundit, për shkak të kombinimit të një morie faktorësh, analiza e të cilëve del paksa jashtë synimit të këtij punimi, është karakterizuar nga një rritje përgjithësisht e dobët, e cila nuk lidhet veç me tregtinë me rajonin, por pasqyrohet në të. Kjo prirje negative ka qenë më e theksuar veçanërisht në drejtim të eksporteve, të cilat kanë pësuar madje edhe ulje nga viti në vit. Ndaj eksportet e Shqipërisë në vitin 2016, ishin më të ulëta në vlerë se eksportet e tre viteve më parë (gjatë vitit 2013), duke shënuar një ecuri të rrallë që nuk ka ndodhur as në vitin 1997.

Rritja anemike e tregtisë së jashtme të vendit gjatë 2-3 viteve të fundit, ndërkohë që vendet e rajonit kanë përjetuar ritme të kënaqshme rritjeje të tregtisë, pasqyrohet dhe ndikon edhe në tregtinë me rajonin dhe Kosovën, duke zbehur disi rezultatet e arritura në vitet e para të kësaj periudhe dhjetëvjeçare. Pikërisht për këtë arsye, tregtia me rajonin arriti kulmin e saj me eksportet në vitin 2015 dhe importet në vitin 2014, ndërkohë që në tregtinë me Kosovën, eksportet arritën kulmin e tyre në vitin 2015 dhe

importet në vitin 2013, duke pësuar një prirje uljeje në periudhën e mëpasshme.

1. Tregtia me Kosovën si pjesë e tregtisë së jashtme të Shqipërisë.


Gjatë dhjetë viteve të fundit, tregtia në mallra me jashtë e Shqipërisë është rritur me ritme të kënaqshme, prej mesatarisht 9.1 % në vit: kështu eksportet kanë pasur rritje mesatare vjetore më të shpejtë prej 12.1% dhe peshë më të ulët në shkëmbimet tregtare (rreth 29.6% gjatë 2016), ndërsa importet, rritje rreth 6.8% dhe peshën kryesore të tregtisë në mallra (rreth 70.4% gjatë 2016).

Që prej viteve '90, Bashkimi Europian ka qenë dhe mbetet partneri kryesor tregtar i Shqipërisë. Tregtia me Bashkimin Europian sot përbën 67% ose 2/3 e tregtisë së jashtme të Shqipërisë, me një ulje të lehtë nga 71% e tregtisë që ajo përbënte 10 vite më parë. Rreth 1/3 e tregtisë me Bashkimin Europian, përbëhet nga eksportet, të cilat janë rritur mesatarisht 10.6% në vit gjatë 10 viteve të fundit, ndërsa importet zënë 66% të tregtisë me Bashkimin Europian, dhe ato janë rritur mesatarisht prej rreth 6.2% në vit. Italia, Gjermania dhe Greqia janë partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë nga Bashkimi Europian, pasi 76.6% e tregtisë me BE-në gjatë vitit 2016 ishte e përqendruar vetëm me këto tri shtete.

Ulja relative e peshës së tregtisë me Bashkimin Europian gjatë 10 viteve të fundit (nga 71% në 67%) është kompensuar kryesisht nga thellimi më i shpejtë i marrëdhënieve tregtare me vendet e rajonit, përfshirë Kosovën. Si rezultat i një klime më bashkëpunuese në rajon dhe falë funksionimit të marrëveshjes së tregtisë së lirë CEFTA, tregtia me Kosovën sot përbën 2.7% të tregtisë së jashtme të Shqipërisë, nga vetëm 1.1% që ajo ishte në vitin 2006, ndërsa tregtia me vendet e tjera të rajonit (Mali i Zi, Maqedoni, Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë) përbën mbi 5% të tregtisë së jashtme të Shqipërisë, gjithashtu me rritje relative në peshën e tregtisë së jashtme prej vitit 2006.

Grupimi i tretë i vendeve partnere në tregtinë e jashtme të Shqipërisë, që përbën rreth 1/4 e saj, përfshin të gjitha vendet e tjera të botës ku peshën

kryesore e kanë Turqia dhe Kina. Në dallim nga dy grupimet e tjera të përmendura më sipër, shkëmbimet tregtare me këtë grup vendesh janë thellësisht të mbizotëruara nga importet prej këtyre vendeve ndërsa eksportet përbëjnë vetëm rreth 11% të tregtisë.




Grafiku Nr. 1 paraqet në mënyrë të përmbledhur këtë evolucion të tregtisë së jashtme të Shqipërisë gjatë periudhës 2006-2016, në total, sipas tre grupimeve kryesore tregtare të përmendura më sipër, si dhe veçmas për Kosovën. Grafiku gjithashtu paraqet edhe tendencën e rritjes së eksporteve dhe importeve përkatëse, shprehur sipas rritjes mesatare vjetore të tyre përgjatë dimensionit horizontal për eksportet, si dhe atij vertikal për importet. Grafiku dëshmon se rritja e tregtisë së jashtme të Shqipërisë me Kosovën ka qenë e lartë në të dy dimensionet e saj, si në eksporte (rritja mesatare vjetore 19%), ashtu edhe në importe (rritja mesatare vjetore 15.3%), e madje në rastin e importeve prej Kosovës, ritmi mesatar vjetor i rritjes ka qenë më i lartë se i njëjti tregues për tre grupimet kryesore të partnerëve tregtare të Shqipërisë.

Por po të lëmë mënjanë tregtinë me vendet e tjera e BE-në, dhe të kemi një

vështrim më të fokusuar vetëm mbi tregtinë me vendet e rajonit, përfshirë Kosovën, vërehet se gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, Shqipëria ka rritur me ritme të larta eksportet drejt gjithë vendeve të rajonit (përfshirë Bosnjë-Hercegovinën, e cila si pasojë e distancës gjeografike dhe nivelit të zhvillimit, mbetet më e izoluar në marrëdhëniet tregtare me Shqipërinë), pasi eksportet në rajon kanë shënuar rritje në nivelin mesatar vjetor 15-27% me të çdo vend. Si rrjedhojë, gjatë dhjetë viteve të fundit, tregtia jonë me rajonin është katërfishuar në vlerë, nga rreth 140 milionë euro në mbi 560 milionë euro, ndërsa eksportet shqiptare në rajon janë rritur mbi 6 herë gjatë së njëjtës periudhë.

Ndërkohë importet nga rajoni për të njëjtën periudhë janë rritur në masë të ndryshme: në nivel të ulët me Maqedoninë dhe Kroacinë, të lartë me Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën, dhe mesatarisht mbi 20% në vit me Serbinë dhe Malin e Zi. Dy shtetet e fundit të rajonit, së bashku me Kosovën, janë pikërisht ato që kanë thelluar tregtinë me Shqipërinë më shumë se të tjerat, si në importe ashtu edhe në eksporte, përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

GRAFIKU 2: TREGTIA E JASHTME E SHQIPËRISË ME VENDET E RAJONIT 2006-2016



Pavarësisht ritmeve të larta të rritjes së tregtisë, Shqipëria ashtu si dhe dhjetë vite më parë, vazhdon të ketë një bilanc negativ tregtar me rajonin dhe çdo vend të tij, me përjashtim të Kosovës. Niveli i mbulimit të importeve nga eksportet në rajon arriti në 80.1% në vitin 2016, nga 42.6% që ky raport ishte në vitin 2006.

2. Tregtia në mallra me Kosovën.

Kosova është i vetmi partner tregtar në rajon, me të cilin Shqipëria gjatë viteve të fundit ka një bilanc tregtar pozitiv. Kështu në vitin 2016, eksportet përbëjnë 74% të tregtisë me Kosovën dhe mbulimi i importeve nga eksportet në Kosovë është në nivelin 285%, nga 208% që i njëjti tregues ishte në vitin 2006. Por më i rëndësishëm është fakti se tregtia mes dy shteteve shqiptare është mbi pesëfishuar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, nga rreth 30 milionë euro gjatë 2006, në 165 milionë euro në 2016 (theksojmë se tregtia me Kosovën arriti vlerën më të lartë në vitin 2015, me 194 milionë euro). Sikurse u përmend më parë, kjo rritje është thelluar si në importe nga Kosova, ashtu edhe në eksporte drejt saj dhe ecuria vjetore e kësaj tendence pasqyrohet në grafikun nr. 3

GRAFIKU 3: ECURIA E IMPORTEVE DHE EKSPORTEVE DHE PESHA E TREGTISË ME KOSOVËN, SI PJESË E TREGTISË ME RAJONIN 2006-2016

Prej të dhënave të pasqyruara në grafik vihet re se rritja e tregtisë me Kosovën ka qenë më e lartë deri në vitet 2012-2013 dhe pas kësaj periudhe, importet nga Kosova kanë pasur rritje modeste ndërsa eksportet kanë pësuar edhe ulje, duke shënuar vlerën e tyre më të lartë në vitin 2015. Si rezultat i këtij ngadalësimi gjatë 3-4 viteve të fundit, pesha relative që tregtia me Kosovën zë në tregtinë e Shqipërisë me vendet e rajonit, ka ardhur gradualisht në ulje, prej kulmit 32.5% arritur në vitin 2013, në 28% të tregtisë me rajonin gjatë vitit 2016.

Me gjithë ritmet e larta të rritjes së tregtisë me Kosovën dhe peshës së saj në tregtinë e jashtme të Shqipërisë, ajo mbetet në një nivel të ulët krahasuar me partnerët e tjerë tregtarë, duke paraqitur aktualisht më pak se 3% të saj.

Cilët janë faktorët që pengojnë rritjen edhe më të vullshme të tregtisë mes Shqipërisë dhe Kosovës? Si shpjegohet që megjithëse pjesë të të njëjtit komb, gjeografikisht afër, me infrastrukturë lidhëse të përmirësuar veçanërisht pas investimit madhor e hapjes së Rrugës së Kombit që padyshim ndihmon tregtinë, me pengesa tregtare të reduktuara në vazhdimësi, me vullnet të përbashkët e të padiskutueshëm politik e

shtetëror midis dy vendeve për të thelluar bashkëpunimin ekonomik, ende marrëdhëniet tregtare me Kosovën përbëjnë një pjesë tepër të vogël të tregtisë së jashtme të Shqipërisë?


Shpjegimi kryesor që teoritë e integritit tregtar japin në raste të tilla lidhen me përfitimet e kufizuara që vendet e përfshira në procese integruese arrijnë të marrin në rastet kur niveli i zhvillimit ekonomik të tyre është krahasimisht i ngjashëm (Michael Porter: *The Competitive Advantage of Nations*, New York: Free Press, 1990). Sa më i ngjashëm është niveli i zhvillimit dhe struktura ekonomike mes vendeve të përfshira në një proces integrimi, aq më lehtë e shpejt realizohet procesi i integritit në praktikë, por po aq më të vogla janë edhe përfitimet përkatëse nga vendet që integrohen ekonomikisht me njëri-tjetrin. Rasti i Shqipërisë me Kosovën duket se është një ilustrim i këtij faktori të rëndësishëm, sikurse e njëjta teori vërtetohet edhe në modelin e anasjelltë, sipas të cilit vendet që integrohen kanë përfitime shumë më të larta dhe procesi është më i vështirë në rastet kur ekzistojnë ndryshime thelbësore të strukturave ekonomike dhe nivelit të zhvillimit mes tyre. Marrëdhëniet tregtare dhe orientimi i tregtisë së Shqipërisë drejt Bashkimit Europian, edhe në sajë të proceseve integruese me Bashkimin Europian (kujtojmë që Shqipëria ndodhet gjithashtu në tregti të lirë me Bashkimin Europian në kuadër të MSA-së), sikurse dhe përfshirja e reformave të ndërmarra në kuadër të këtij procesi, ilustrojnë më së miri vërtetësinë e të njëjtit argument.

Përfshirja nga ky shpjegim përbëjnë aktivitetet ekonomike komplementare në të dy vendet. Rasti i sistemeve energjetike që realisht (mund të) plotësojnë njëri-tjetrin për të krijuar një vlerë ekonomike shumë më të madhe se shuma e vlerave të izoluara të tyre, njihet mirë dhe është kthyer thuajse në një simbol të përhershëm të diskutimeve mes vendeve. Progres drejt këtij synimi ka pasur, por sot jemi ende larg funksionimit të një modeli të integruar që do t'i shërbente sipas këtij modeli ekonomisë së përbashët të të dy vendeve. Turizmi malor shoqëruar me atë të detit, prodhimet bujqësore e blegtorale e disa industri të caktuara si ato minerare dhe përpunimit mund të konsiderohen deri diku raste të ngjashme komplementare, por numri i tyre është i kufizuar dhe

pritsmëritë mbi zhvillimin e tregtisë nuk mund të bazohen veç mbi to.

Një tjetër faktor që ndikon në kufizimet e tregtisë Shqipëri-Kosovë lidhet jo vetëm me ngjashmërinë, por edhe me nivelin real të zhvillimit të ekonomisë së dy vendeve, e cila bazohet kryesisht në biznese të vogla dhe të mesme, përgjithësisht me natyrë aktiviteti lokal dhe pa ambicie të dukshme eksportuese. Mund të tingëllojë paradoksale, por në të vërtetë, sa më tepër hapet tregu, aq më shumë theksohen prirjet e bizneseve me fuqi të ulët konkurruese për të kufizuar aktivitetin e tyre brenda zonës lokale ku ndihen më të sigurta dhe të izoluara nga risqet e konkurrencës. Një argument i tillë tregon jo vetëm përse bizneset e vogla mbeten të tilla, por shpjegon se edhe sikur realisht të mos kishte aspak kufi dhe doganë mes dy shteteve shqiptare, sërish pjesa më e madhe e bizneseve nuk do të kishin prirje për të zgjeruar aktivitetin nga njëri vend në tjetrin, ashtu sikurse ndodh rëndom që një biznes në cilindo qytet të Shqipërisë nuk ka përparësi kryesore të zgjerojë aktivitetin në një qytet tjetër, pa përmendur hapësirat që ai mund të gjejë në tregun e Kosovës, apo dhe më gjerë në rajon.


GRAFIKU 4: EKSPORTET E SHQIPËRISË DREJT KOSOVËS DHE EGURIA E TYRE 2006-2016



Nën të njëjtin këndvështrim, për shkak të nivelit ende të ulët të zhvillimit të Shqipërisë dhe Kosovës, kufizimet në tregti burojnë edhe prej mundësive të kufizuara që bizneset e të dy vendeve mund t'i ofrojnë njeri-tjetrit, në kushtet kur kërkesa për produkte mund plotësohet në kushte më konkurruese prej vendeve të tjera. Edhe sikur kufiri të mos ekzistojë, si Shqipëria, ashtu dhe Kosova do të jenë të varura nga shkëmbimet tregtare me vendet e tjera, pasi ekonomitë nuk mundën që të plotësojnë nevojat e njëra-tjetrës për pjesën dërrmuese të produkteve të tregtuara.


Kjo vihet re edhe po të shohim strukturën e importit dhe eksportit drejt Kosovës gjatë viteve të fundit. Struktura e tyre është pak e diversifikuar, tepër e kufizuar dhe e përqendruar në produkte me vlerë të shtuar të ulët. Kështu eksportet dominohen nga metalet, çimento apo nënproduktet e naftës dhe në një masë më të ulët prej vajrave, bojërave, farmaceutikës, fruta-perimeve etj. Importet, që janë edhe më të kufizuara, përbëhen kryesisht prej pijeve (birra, uji, lëngjet e frutave), miellit, metaleve dhe perimeve. Grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë strukturën e produkteve të shkëmbyera, përfshirë vlerën e tyre, peshën relative në import/eksportin total të secilit produkt si dhe tendencën e rritjes mesatare vjetore gjatë periudhës 2006-2016.

GRAFIKU 5: IMPORTET E SHQIPËRISË NGA KOSOVA DHE ECURIA E TYRE 2006-2016



Edhe pse vlera dhe struktura e produkteve të shkëmbyera me Kosovën është e kufizuar, për të parë më nga afër shkallën e orientimit të tregtisë mes dy shteteve sipas produkteve, grafikët e mëposhtëm pasqyrojnë përqëndrimin e produkteve të shkëmbyera drejt (eksportet) dhe prej (importet) Kosovës. Pra jo vetëm cilët janë produktet më të shkëmbyer, por dhe cilët janë produktet më të orientuar në tregti me Kosovën, krahasuar kjo në mënyrë relative me partnerët e tjerë tregtarë të Shqipërisë.


GRAFIKU 6: PËRQENDRIMI I EKSPORTEVE NË TREGTINË ME KOSOVËN SIPAS PRODUKTEVE, 2016



Një analizë e tillë tregon se ka eksporte të Shqipërisë të cilat janë së tepërmi të orientuara drejt tregut të Kosovës, si tapat e shisheve (të cilat eksportohen plotësisht vetëm në Kosovë), gjithashtu produkte ushqimore, kimikatet etj., por vlera e tyre është realisht e vogël. Produktet me vlerë më të konsiderueshme rezultojnë vajrat dhe bojërat, eksportet drejt Kosovës së të cilave përbëjnë respektivisht 85% dhe 52% të eksportit total të Shqipërisë në këto produkte.


Analiza e importeve tregon se shkalla e 'varësisë' nga tregu i Kosovës është shumë më e ulët. Të vetmet importe të konsiderueshme janë mielli, zarzavatet dhe pijet, të cilat zënë respektivisht 22%, 15% dhe 9.5% të importit total të Shqipërisë për secilin produkt. Kjo analizë në nivel produktesh dëshmon se shkalla e specializimit të ekonomive në produkte që i shërbejnë tregut të të dy vendeve është shumë e kufizuar.

GRAFIKU 7: PËRQENDRIMI I IMPORTEVE NË TREGTINË ME KOSOVËN, 2016



Një rezultat i ngjashëm del edhe nga analiza e shkëmbimeve tregtare të Kosovës me Shqipërinë. Dallimi kryesor lidhet me faktin se tregtia mes dy shteteve rezulton më e rëndësishme për Kosovën se në rastin e Shqipërisë, fakt që shpjegohet me orientimin më të madh të tregtisë së Shqipërisë drejt Bashkimit Europian dhe përmasave të ndryshme të ekonomive të të dy vendeve. Kështu importet nga Shqipëria përbëjnë 6% të importeve të Kosovës, ndërsa eksportet drejt Shqipërisë mbi 12% të eksporteve të Kosovës gjatë vitit 2015.


Të dhënat e mësipërme tregojnë kufizimet që ekzistojnë në tregtinë Shqipëri-Kosovë, por njëkohësisht ato tregojnë edhe potencialin ende të pashfrytëzuar të përfitimeve që burojnë prej këtij bashkëpunimi, i cili për produkte të caktuara ka ardhur duke u konsoliduar ndër vite, duke thelluar aktivitetin ekonomik në të dy vendet.

GRAFIKU 8: TREGTIA E KOSOVËS ME SHQIPËRINË DHE PESHA E SAJ NË TREGTINË ME JASHTË TË KOSOVËS⁵

Një element tjetër që duhet përmendur si faktor ndikues në tregtinë midis Shqipërisë e Kosovës lidhet me traditën historike të funksionimit dhe shkallën e inercisë së kanaleve të tregtisë, të cilat kërkojnë kohën e nevojshme për t'u riorientuar drejt mundësive të reja në treg. Është pikërisht ky faktor që mban Shqipërinë në vazhdimësi të hapur drejt tregut evropian, ndaj të cilit Shqipëria është nisur të orientohet që në fillim të viteve 90', sikurse edhe Kosovën ndaj vendeve të tjera të rajonit, për shkak të marrëdhënieve historike tregtare me këto vende.

Fakti që shkëmbimet tregtare mes Shqipërisë e Kosovës dominohen nga produktet e 'rënda' dhe me vlerë të shtuar të ulët reflektohet jo vetëm në shifrat e importeve dhe eksporteve, por edhe në vlerën reale të tyre. Të dhënat e disponueshme nga Eurostat dhe INSTAT na tregojnë se vlera mesatare për 1 ton mall që qarkulloi në Bashkimin Evropian gjatë vitit 2016 ishte 1,732 euro, ndërkohë që i njëjti tregues për tregtinë mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është 1,147 euro dhe për tregtinë mes Shqipërisë dhe Kosovës vetëm 171 euro. Grafiku i mëposhtëm tregon gjithashtu të njëjtin tregues në tregtinë me disa vende të tjera të rajonit

dhe na shpjegon ngarkesën e Rrugës së Kombit me makina të rënda transporti që qarkullojnë përgjithësisht skrap, hekur, çimento apo produkte të tjera me vlerë të shtuar të ulët, gjë që shtyn nevojën e ndërtimit të politikave të përbashkëta për ndërtimin e fuqizimin e industrive shumë më produktive dhe konkurruese në tregun e përbashkët.



Së fundmi, nuk mund të mohojmë se edhe pse mjaft përparim është arritur në lehtësimin e tregtisë midis Shqipërisë dhe Kosovës, situata mbetet ende larg asaj ideale. Bizneset e të dy anëve të kufirit shqiptar ankohen vazhdimisht për pengesat e ndryshme administrative, infrastrukturore, të kostove të panevojshme për të kryer tregti apo dhe masave mbrojtëse, shoqëruar me ekzistencën e ekonomive të karakterizuara nga pozicione oligopoliste apo monopoliste në treg, faktorë të cilët së bashku dëmtojnë edhe më tej mundësitë e kufizuara që ekzistojnë për tregti midis dy vendeve.

3. Tregtia në shërbime me Kosovën

Edhe pse tregtia në shërbime nuk përfshihet në këtë analizë, është e

nevojshme të theksohet se pesha e saj është jashtëzakonisht e rëndësishme në bashkëpunimin ekonomik me Kosovën. Në të dy vendet, shërbimet përbëjnë mbi 50% të prodhimit të brendshëm dhe po kështu importi dhe eksporti i tyre është i krahasueshëm në vlerë me tregtinë në mallra, e madje për rastin e eksporteve të Shqipërisë, edhe më i madh në vlerë se eksporti i mallrave.

Por ka disa faktorë që ndihmojnë sektorin e shërbimeve që të jetë edhe më efikas se tregtia në produkte nën këndvështrimin e integritit midis ekonomive të Shqipërisë dhe Kosovës. Nga vetë natyra e tyre, shërbimet nuk hasin pengesa doganore apo kosto të tjera që ndikojnë në tregtinë në mallra. Kalimi i një fundjave apo pushimeve në bregdetin e Durrësit apo Grykën e Rugovës nuk paraqet asnjë lloj pengese për cilindo që dëshiron të përfitojë shërbimet e ofruara në të dy anët e kufirit shqiptar. Po kështu, përdorimi i gjuhës shqipe lehtëson padyshim përthithjen e shërbimeve dhe i vendos ato në pozitë avantazhi krahasuar me shërbime të ngjashme të ofruara nga operatorë të tjerë në treg, për rastet kur cilësia e këtyre shërbimeve është e ngjashme – rasti i shërbimeve në zgjidhjet IT, multimedia, televizione etj., e dëshmon këtë fakt. Natyrisht edhe preferencat e konsumatorëve në të dy tregjet ndikohen drejtpërdrejt nga origjina e shërbimeve të ofruara, madje një ndikim i tillë për shumë shërbime është edhe më i fuqishëm se preferencat e konsumatorëve për produktet e prodhuara në të dy vendet krahasuar me ato që kanë origjinë prej vendeve të tjera.

Së fundmi, afërsia gjeografike, kombinuar me avantazhin që shërbimet kanë krahasuar me mallrat për shkak të varësisë më të vogël të tyre ndaj infrastrukturës lidhëse midis dy vendeve, ka ndihmuar sidomos bizneset e Shqipërisë që të gjejnë një zgjerim natyral të aktivitetit të tyre përtej kufirit, pikërisht në Kosovë. Për këtë arsye për shembull, qysh herët dhe ende pa u ndërtuar Rruga e Kombit, ka mjaft biznese të suksesshme të Shqipërisë që kanë zgjeruar aktivitetin e tyre në Kosovë, sikurse dhe anasjelltas, ndërkohë që për tregtinë në mallra, infrastruktura lidhëse mes dy vendeve ka qenë, por edhe mbetet në disa faktorë problem i konsiderueshëm.

Pavarësisht se një pjesë e shërbimeve mes dy vendeve mbeten subjekt i rregullimit të tregjeve përkatëse, sikurse edhe hyrja në tregun e fushave të caktuara, nuk është e lehtë për shkak të strukturave ekzistuese që ato kanë dhe mungesës së një konkurrence të hapur, tregtia në shërbime është shembulli më i mirë i arritur në drejtim të një integrimi të thelluar ekonomik midis Shqipërisë dhe Kosovës. Veçanërisht të suksesshme kanë qenë:

- kompanitë e sigurimeve
- turizmi mes dy vendeve
- kompanitë e ndërtimit dhe transportit
- bizneset me aktivitet në zgjidhjet e IT
- multimedia e televizione
- shërbime financiare, ligjore dhe këshilluese
- shërbimet shëndetësore etj.

Duhet theksuar gjithashtu se aktivitete të tilla kanë ardhur duke u rritur, duke krijuar edhe më tej premisa që ato të jenë njësoj të suksesshme edhe në vende të tjera të rajonit. Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e vizitorëve nga Kosova që kanë hyrë në Shqipëri gjatë viteve të fundit. Duket qartë se vetëm brenda 4 vitesh, numri i vizitorëve është rritur nga 1.3 milionë në 2.2 milionë në vit, faktor që ndikon drejtpërdrejt në aktivitetin e sektorit të turizmit në Shqipëri.

4.Mundësi për një thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar Shqipëri – Kosovë

Diskutimet mbi mundësitë për të shpënë më tej marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës kanë qenë të vazhdueshme dhe ato burojnë natyrshëm prej perceptimit të drejtë, se këto marrëdhënie nuk kanë qenë dhe ende nuk janë në nivelin e dëshirueshëm jo vetëm nga faktorët politikë, por edhe nga bizneset, konsumatorët dhe mbarë shoqëria shqiptare e të dy anëve të kufirit mes saj. Rrjedhimisht, gjatë viteve të fundit janë konsoliduar një sërë propozimesh mbi drejtimet në të cilat duhet kërkuar thellimi i bashkëpunimit ekonomik, sikurse edhe modele, sipas të cilave ai mund të bazohet.

Pa hyrë në detajet e hollësishme të propozimeve, të cilat janë shtjelluar gjerë e gjerë në mjaft forume të niveleve të ndryshme, përmendim shkurtimisht se në pjesën më të madhe ato konvergojnë përgjithësisht në drejtimet e mëposhtme:

- Përdorimi i potencialit ende të pashfrytëzuar në shkëmbimet midis Shqipërisë dhe Kosovës, duke pasur parasysh mundësitë ekzistuese të kërkesës dhe ofertës në të gjithë hapësirën e tregut shqiptar, por edhe ato që mund të burojnë pikërisht në sajë të një integrimi më të thellë ekonomik brenda saj.
- Zhvillimi i infrastrukturës lidhëse mes dy vendeve ku natyrshëm vëmendja, së pari përqendrohet në përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve lidhëse, por edhe më gjerë, duke përfshirë rolin e porteve të Durrësit dhe Shëngjinit, ndërtimin dhe përmirësimin e rrjeteve rrugore kufitare dhe në zona të tjera veç asaj të Morinit, modernizimin e sistemit doganor, rrjeteve të energjisë elektrike dhe telekomunikacionit, përfshirjen në korridoret rajonale infrastrukturore etj. Vlen të përmendet në këtë aspekt se funksionimi i pritshëm me pagesë i Rrugës së Kombit, pavarësisht përfitimeve të kufizuara, bie ndesh me këtë frymë dhe do të sjellë efekte frenuese në drejtim të fuqizimit të kanaleve të tregtisë Shqipëri – Kosovë, por nuk ka ende ndonjë propozim konkret se si kjo pengesë shtesë në tregtinë mes dy vendeve do të trajtohet për zgjidhje në të ardhmen.
- Shfrytëzimi i përbashkët i mundësive komplementare (energji, turizëm, miniera etj.) dhe aktiviteteve ekonomike me vlerë të shtuar të lartë. Ky faktor i rëndësishëm u trajtua edhe më lart dhe ndonëse njihet mirë dobia e përfitimeve të përbashkëta nga një koordinim i mirë i shfrytëzimit të mundësive komplementare, si në aktivitetet private (p.sh., turizmi malor/deti) apo edhe publike (prodhimi i kombinuar i energjisë HEC/TEC), pavarësisht progresit të kryer, jemi ende larg arritjeve të prekshme në këtë drejtim që për raste të tjera ka qenë i suksesshëm. Në fakt, koordinimi sipas këtij faktori mbetet sërish ndër më të rëndësishmit për të ardhmen.
- Lehtësimi dhe eliminimi i mëtejshëm i procedurave dhe kostove doganore, i cili dukshëm mbetet problem shqetësues për bizneset e të dy

vendeve dhe veçanërisht bizneseve të vogla që kërkojnë të zgjerojnë aktivitetin e tyre përtej kufirit. Ekzistenca e pengesave jo-tarifore – certifikatat, rregullat e origjinës etj., por edhe ato që lidhen me kostot doganore (çmimet e referencës, tarifatat për shërbimet doganore etj.) kërkon një angazhim të plotë dhe serioz për identifikimin e plotë dhe marrjen e masave për eliminimin, ose së paku reduktimin e tyre.

- Harmonizimi i procedurave administrative nga institucionet e të dy vendeve buron si një nevojë e domosdoshme për të njehsuar çdo element të klimës dhe funksionimit të biznesit në mënyrë që bizneset e të dy krahëve të kufirit të ndihen si “në shtëpinë e tyre” kudo që ato ushtrojnë aktivitetin e tyre, në një ambient të qartë, të parashikueshëm dhe me të drejta të barabarta ushtrimi të aktivitetit apo procedurave të ankimit ndaj institucioneve.
- Koordinimi i politikave dhe instrumenteve të zhvillimit, për të përfituar nga sinergjitë në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të zgjeruar dhe të integruar mes tij. Në këtë drejtim është arritur përparim nëpërmjet organizimit të mbledhjeve të përbashkëta të qeverive, si dhe institucioneve homologe, qeveritare apo private dhe të shoqërisë civile, por mjaft punë mbetet për të kryer në drejtim të jetësimit të angazhimeve politike dhe realizimit të programeve të përbashkëta të financimeve dhe zhvillimit, veçanërisht në zonat pranë kufirit.
- Njehsimi i faktorëve të tjerë të klimës së biznesit, përfshirë qasjen fiskale kërkon harmonizimin e politikave përkatëse për zhvillimin e biznesit, me synim krijimin e një ambienti sa më uniform në trajtimin e biznesit, por që do të inkurajonte konkurrencën e lirë dhe zhvillimin e bizneseve bazuar në konkurrueshmërinë e tyre në treg.
- Angazhimi i diasporës, si një prioritet dhe avantazh i përdorur jo sa duhet prej të dy vendeve, do të krijonte potenciale edhe më të mëdha për pjesëmarrjen e diasporës në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës, duke forcuar edhe më tej bashkëpunimin mes vendeve dhe duke fuqizuar aftësinë konkurruese të kompanive shqiptare në rajon dhe më gjerë.

Funksionimi i pritshëm me pagesë i Rrugës së Kombit, pavarësisht përfitimeve të kufizuara, bie ndesh me këtë frymë dhe do të sjellë efekte frenuese në drejtim të fuqizimit të kanaleve të tregtisë Shqipëri – Kosovë, por nuk ka ende ndonjë propozim konkret se si kjo pengesë shtesë në tregtinë mes dy vendeve do të trajtohet për zgjidhje në të ardhmen.

Edhe pse është e qartë që propozimet e mësipërme nuk mund të funksionojnë veçmas njëra-tjetrës, por duhet të mbështeten në sinergjitë që secila krijon, konsensusi i përgjithshëm mbi rëndësinë e tyre nuk mund të zëvendësojë modelin mbi të cilin ato mund të konkretizohen në marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës. Për këtë qëllim, si në marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë, ashtu dhe në kuadër të të gjithë rajonit, janë propozuar disa modele të përdorura në përvoja të tjera në botë, të cilat paraqiten më poshtë:

- a. Rajoni si pjesë aspiruese për në Bashkimin Europian
- b. Bashkimi doganor
- c. Thellimi i CEFTA-s

d. Hapësirë edhe më e integruar, si një treg i përbashkët shqiptar

Natyrisht që ka dhe propozime që vijnë si kombinime të modeleve të mësipërme, por duke konsideruar modelin ekzistues të shkëmbimeve tregtare si dhe vlerësimet historike mbi rezultatet e tij që u trajtuan më sipër, përpara se të analizohen modele alternative, natyrisht vlen të kuptohet sa i dobishëm ka qenë modeli ekzistues.

[1] Z. Ilir Ciko është pedagog në Institutin Kanadez të Teknologjisë në Tiranë. Ai ka një eksperiencë shumëvjeçare me studimin, hartimin dhe zbatimin e politikave tregtare në Shqipëri dhe Kosovë.

[2] Të gjitha të dhënat e përdorura, nëse nuk tregohet ndryshe, janë marrë nga INSTAT – www.instat.gov.al

[3] Të gjitha llogaritjet mesatare të përdorura në këtë punim bazohen në

mesataren e thjeshtë të rritjes vjetore (Compounded Average Growth Rate).

[4] Ndonëse Kroacia me pranimin në Bashkimin Europian nuk është më pjesë e CEFTA-s, ajo është përfshirë në këtë studim si pjesë e rajonit për shkak të afërsisë gjeografike dhe pasi ajo gëzon të njëjtin status preferencial në tregtinë me Shqipërinë, si para dhe pas hyrjes në Bashkimin Europian. Në të njëjtën logjikë, edhe pse Moldavia është pjesë e CEFTA-s, ajo nuk është përfshirë për shkak të distancës nga rajoni dhe nivelit të papërfillshëm të shkëmbimeve tregtare me Shqipërinë.

[5] Agjencia e Statistikave të Kosovës – <http://ask.rks-gov.net/>



Sa ka funksionuar CEFTA?

Marrëveshja rajonale e tregtisë së lirë CEFTA, që përfshiu vendet e rajonit në vitin 2006, pas suksesit të saj në Europën Qendrore, ka ndihmuar vendet e rajonit të Ballkanit të thellojnë tregtinë mes tyre dhe të reduktojnë ndjeshëm pengesat tregtare, gjë që do të kishte qenë shumë më e vështirë përmes rrjetit të marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë që funksionuan deri në vitin 2006 mes këtyre vendeve. CEFTA ka institucionet e saj, të cilat kanë ndihmuar në zgjidhjen e problemeve tregtare mes vendeve. Nga këndvështrimi institucional dhe në interes të shqiptarëve e veçanërisht të Kosovës, CEFTA ende mbart një handicap rudimentar – atë të mosnjohjes së plotë të Kosovës si shtet i lirë dhe i pavarur, për shkak të refuzimit të Serbisë dhe pranisë së UNMIK-ut si përfaqësues i Kosovës në themelimin e

CEFTA-s për rajonin.

Edhe në sajë të CEFTA-s, për Shqipërinë tregtia me rajonin gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është rritur me ritme tepër të shpejta, më shumë se me pjesën tjetër të botës. Kështu në këto dhjetë vite, eksportet shqiptare drejt rajonit janë rritur mesatarisht me rreth 21% në vit dhe importet me mbi 14% në vit. Si rezultat, tregtia me rajonin në dhjetë vite është thuhet katërfishuar dhe pesha e saj në tregtinë e jashtme të Shqipërisë ka shkuar nga 3.7% në vitin 2006, në 8.1% gjatë vitit 2016. Shqipëria gjithashtu ka pasur përmirësim të performancës së eksporteve ndaj rajonit, pasi në dhjetë vite, mbulimi i importeve nga rajoni prej eksporteve drejt tij është përmirësuar nga rreth 40% në mbi 80%. Kosova gjithashtu ka pasur thellim të tregtisë së saj me vendet e rajonit.

Pavarësisht kësaj rritjeje të lartë të tregtisë, një pjesë e së cilës i takon padyshim rolit të CEFTA-s, zbatimi i marrëveshjes ka hasur edhe probleme që në raste të caktuara janë edhe shqetësuese. Kështu jo rrallë vendet e CEFTA-s janë përfshirë në konflikte tregtare mes tyre, që janë përshkallëzuar në mungesë të zgjidhjeve brenda marrëveshjes. Gjithashtu, rezultatet e marrëveshjes janë më të dukshme gjatë viteve të para të funksionimit të saj, ndërkohë që ka një tendencë rënieje të ritmeve të larta të shkëmbimeve dhe mungesë progresi në fusha të caktuara.

Por problemi kryesor i funksionimit të CEFTA-s lidhet me përfitimet e pabarabarta nga marrëveshja, që vijnë nga niveli i pabarabartë i zhvillimit të ekonomive dhe industrive të caktuara në vendet e CEFTA-s, në kushtet kur hapja e tregut, së paku në mallra, është e njëjtë nga të gjitha vendet. Si rrjedhojë e këtij faktori, ka pasur zhvendosje të tregtisë brenda rajonit, duke u dhënë më tepër mundësi atyre ekonomive që mund të ofronin më tepër në tregun rajonal.

Për ilustrim: Më lart u përmend se Shqipëria dhe Kosova kanë pasur shkëmbime të vrullshme tregtare gjatë dhjetë viteve të fundit. Por pavarësisht kësaj, në vitin 2006 shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me Kosovën ishin sa dyfishi i shkëmbimeve tregtare midis Shqipërisë dhe

Serbisë. Sot, pra dhjetë vite më pas, edhe pse nuk kemi pasur mbledhje të përbashkët të qeverive, preferenca apo vullnete politike apo infrastrukturë të përmirësuar, tregtia Shqipëri-Serbi rezulton se është më e madhe se ajo Shqipëri-Kosovë.

Natyrisht, një fakt i tillë pasqyron atë që tregtia nuk njih kufij dhe në fund të fundit, në dukje nuk ka asnjë të keqe nga thellimi i shkëmbimeve tregtare Shqipëri-Serbi; konsumatorët shqiptarë kanë akses në produkte më të shumta dhe çmime më të mira, veçanërisht kur këto nuk ofrohen nga vendet e tjera. Por pikëpyetje të tjera ngrihen kur shihet se një pjesë e këtyre produkteve kanë rëndësi strategjike (si në rastin e varësisë së furnizimit me grurë dhe miell) dhe këto pikëpyetje lidhen më së tepërmi me vazhdimësinë e marrëdhënieve nën modele të propozuara, të cilat mund ta thellojnë edhe më tej këtë varësi.

Po kështu, ndonëse marrëdhëniet tregtare mes vendeve të rajonit kanë përparuar, mund të thuhet se pak ose aspak është arritur në funksion të një prej qëllimeve kryesore të CEFTA-s: nxitjes së investimeve rajonale dhe tërheqjes së investimeve të huaja në rajon.

Shqipëria e Kosova nuk janë aspak të izoluara nga pjesa tjetër e ekonomisë botërore, e aq më pak ajo e rajonit. Si Shqipëria, ashtu dhe Kosova, janë pjesëmarrëse në marrëveshjen rajonale të tregtisë së lirë CEFTA; Shqipëria është anëtare me të drejta të plota e Organizatës Botërore të Tregtisë, ajo ka një marrëdhënie tregtare preferenciale me të gjitha vendet e Bashkimit Europian ku synon anëtarësimin, përmes marrëveshjes së tregtisë së lirë, pjesë e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim dhe së fundi ka arritur ose është në përfshirje të marrëdhënieve tregtare preferenciale me Turqinë, vendet e EFTA-s etj. Ndërtimi i një marrëdhënieje tregtare preferenciale midis Shqipërisë (dhe e njëjta analizë mund të kryhet në mënyrë simetrike dhe për Kosovën, pavarësisht ekspozimit më të reduktuar të saj në marrëveshjet ndërkombëtare të tregtisë) dhe një pale të tretë, së pari do të duhej të respektonte angazhimet e ndërmarra në këto marrëveshje. Së dyti, për strukturimin e formave më të avancuara të

integritet mes Shqipërisë e Kosovës, natyrshëm dalin dy pyetje të lidhura mes tyre të cilat kërkojnë përgjigje: A e ka përmbushur plotësisht marrëveshja tregtare aktuale mes dy vendeve objektivin e saj, duke diktuar nevojën e ndërtimit të një stadi tjetër integritet ekonomik mes dy vendeve? Dhe tjetra – a përbën kjo marrëveshje një pengesë pikërisht për një progres të mëtejshëm në këtë drejtim?

Edhe pse marrëveshja e tregtisë së lirë CEFTA nuk mund të konsiderohet si ndër më të spikaturat në mbi 200 marrëveshjeve të tilla që sot funksionojnë në tregtinë botërore, përgjigjja për të dyja këto pyetje është negative. CEFTA ofron hapësira ende të pashfrytëzuara e në dobi të fuqizimit të tregtisë mes Kosovës dhe Shqipërisë, sikurse nga ana tjetër, marrëveshja nuk paraqet ndonjë vështirësi serioze ndaj një rikonceptimi të mundshëm të marrëdhënieve ekonomike midis dy anëve të kufirit shqiptar. Madje marrëveshja nuk është përdorur si duhet edhe në ato pak raste, shpresojmë të izoluara e që të mos përsëriten në të ardhmen, të pengesave artificiale të tregtisë midis Shqipërisë e Kosovës, ndërkohë që ajo përmban dhe mekanizmat e duhur institucionalë për adresimin dhe zgjidhjen e këtyre problemeve.

Për ilustrim, mund të tingëllojë (ende) paksa si utopike ideja që një kompani e Kosovës të ketë mundësi të aplikojë, konkurrojë si e barabartë apo dhe të fitojë në një tender të zhvilluar nga një Ministri në Tiranë apo një komunë p.sh. në Qarkun e Fierit (përtej faktit që një perceptim të ngjashëm kanë nisur të kenë shumë kompani edhe vetë brenda Shqipërisë). Apo imagjinoni një kompani të suksesshme ndërtimi në Vlorë që me të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor e teknik që ka në Shqipëri, kërkon të pajtohet për të ndërtuar të themi një fshat turistik në Gjakovë apo Pejë. CEFTA përmban klauzola që kërkojnë nga shtetet pjesëmarrëse pikërisht arritjen e një realiteti të tillë, përmes hapjes së tregut të prokurimeve publike ndaj njëri-tjetrit, ndërkohë që realiteti dëshmon se mjerisht pak është bërë në këtë drejtim, jo vetëm me shtetet e tjera të rajonit, por dhe midis Shqipërisë e Kosovës, ku afrimiteti kombëtar, gjeografik, politik apo i çdo lloj

dimensioni tjetër, do të duhej të lehtësonte maksimalisht përmbushjen e angazhimeve që qeveritë përkatëse kanë nënshkruar qartazi në një marrëveshje ndërkombëtare mes tyre.

A i ka plotësuar Shqipëria angazhimet e mësipërme në kuadër të marrëveshjes CEFTA, për të mundësuar hapjen e tregut të saj ndaj kompanive kosovare apo nga vendet e tjera të rajonit? Përgjigjja e shkurtër do të ishte po. Por kjo vetëm, nuk mjafton. Formalisht tregu i prokurimit publik është i hapur për pjesëmarrje të barabartë të kompanive të huaja, përfshirë ato nga Kosova, krahasuar me kompanitë vendase. Në fakt, po të hapë faqen elektronike të prokurimit publik, çdokush, pavarësisht se ku ndodhet në botë, mund të regjistrohet lehtësisht për të marrë pjesë në çdo tender publik të organizuar në Shqipëri, pra nuk ka pengesa për pjesëmarrje të kompanive të huaja në këtë fushë të rëndësishme të aktivitetit ekonomik.

Por regjistrimi është veçse nisja e procedurës së prokurimit. Problemi i vërtetë që kompanitë (përfshirë shumë syresh nga Shqipëria) hasin, nuk është refuzimi i mundësisë së pjesëmarrjes në prokurimet publike, por specifikimet teknike dhe ekonomike që përcaktohen në tendera, të cilat rëndom anojnë dukshëm për të paracaktuar fituesit dhe de facto përjashtojnë nga mundësia e konkurrimit kompanitë e huaja (sikurse dhe ato vendase) që të marrin pjesë në tenderimet publike.

Tenderat

Problemi i vërtetë që kompanitë (përfshirë shumë syresh nga Shqipëria) hasin, nuk është refuzimi i mundësisë së pjesëmarrjes në prokurimet publike, por specifikimet teknike dhe ekonomike që përcaktohen në tendera, të cilat rëndom anojnë dukshëm për të paracaktuar fituesit dhe de facto përjashtojnë nga mundësia e konkurrimit kompanitë e huaja (sikurse dhe ato vendase) që të marrin pjesë në tenderimet publike.

Një situatë e tillë dëshmon se pengesë për thellimin e bashkëpunimit

ekonomik midis Shqipërisë e Kosovës (apo çdo vendi tjetër në rajon), nuk janë aspak kufizimet e marrëveshjes së tregtisë së lirë; përkundrazi në fakt, marrëveshja sikurse në rastin e mësipërm kërkon qartazi arritjen e këtij objekti. Është mënyra e organizimit të tregut të brendshëm, mungesa e konkurrencës së shëndetshme dhe vullneti thuajse minimal nga ana e mekanizmave shtetërore, por në një masë edhe nga vetë bizneset vendase, për të promovuar hapjen e tregut ndaj konkurrencës reale në dobi të fuqizimit dhe specializimit të kompanive vendase, që realisht prodhojnë në treg pengesa artificiale, të cilat nuk mund të kapërcehen përmes klauzolave në marrëveshjet ndërkombëtare, por vetëm nëpërmjet krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues dhe produktiv.

Shembulli i prokurimit publik nuk është i vetëm. Mangësitë në drejtim të hapjes së mëtejshme të tregut kundrejt angazhimeve të CEFTA-s vihen re edhe në tregtinë e shërbimeve, funksionimin e mekanizmave institucionalë të marrëveshjes etj. Po kështu, CEFTA nuk paraqet ndonjë pengesë të rëndësishme ligjore që Shqipëria dhe Kosova të përparojnë në bashkëpunimin e tyre ekonomik edhe përtej kufijve (ende të paarritur) të modelit të konturuar në këtë marrëveshje. Ndaj çdo formë tjetër integrimi ekonomik, që është diskutuar në shumë debate mbi këtë temë, nuk është se duhet domosdoshmërisht të zëvendësojë apriori marrëveshjen ekzistuese.

U përmend dhe më lart që CEFTA nuk paraqet në vetvete ndonjë marrëveshje ideale dhe synimi nuk është kurrësi të mbrojë vazhdimësinë e status quo-së mbi këtë çështje. Aq më tepër që vendet e rajonit janë duke u afruar më tepër me Bashkimin European dhe nuk do të jetë e largët dita kur sikurse Kroacia këtë vit, të braktisin marrëveshjen CEFTA, duke u anëtarësuar në Bashkimin European. Shqetësimi lidhet me faktin që, edhe pse CEFTA mund të mos jetë një marrëveshje e përkryer, si Shqipëria ashtu dhe Kosova, duken ngurruese për të përparuar ashtu si janë zotuar përmes saj, në drejtim të reformave të tregut në dobi të bashkëpunimit ekonomik e fuqizimit të hapësirës ekonomike shqiptare, e kjo sërish, jo për shkak të marrëveshjes.



Modelet e propozuara për një integrim më të thellë midis Shqipërisë dhe Kosovës

I konsideruar nga këndvështrimi i motivimit ekonomik, debati shpesh i përsëritur mbi të ardhmen e tregtisë së lirë mes Shqipërisë e Kosovës, duke përfshirë edhe përzgjedhjen e variantit më të mirë të mundshëm të integritit mes dy ekonomive, teorikisht duhet të përbëjë një paradoks. Historia dhe realiteti i ekonomisë botërore dëshmojnë se mësimet, si ato pozitive, ashtu dhe dështimet e angazhimeve në tregti preferenciale midis dy apo më shumë vendeve, në thelb janë të motivuara nga faktorë kryesisht jo-ekonomikë, ku rolin parësor e kanë çështjet politike, ato të nevojës së krijimit të stabilitetit në një rajon të trazuar apo të rasteve kur është kuptuar se bashkimet e të voglave krijojnë diçka më të madhe se thjesht shuma e tyre. Ekonomia, me lehtësinë e realizimit të bashkëpunimit dhe vendosjes së kufijve, përfitimet e arritshme, dukshmërinë e rezultateve dhe standardizimin e modeleve, përbën mekanizmin më të përkryer për të vënë në funksionim synime të tilla, sikurse është vërejtur në rastet e përpjekjeve dhe suksesit në tregtinë e lirë midis vendeve të Amerikës Qendrore, Azisë Juglindore, apo eksperiencën e Bashkimit European dhe vendeve aktualisht anëtare në CEFTA, ku Shqipëria dhe Kosova aderojnë së bashku.

Por, nëse mund të ketë hapësira për përmirësim të mëtejshëm të bashkëpunimit midis vendeve të rajonit tonë dhe sërish, bashkëpunimi ekonomik del si mjet i dobishëm për të tejkaluar dallimet politike apo historike e për të thelluar integritin jo të lehtë mes këtyre vendeve, në rastin midis Kosovës e Shqipërisë, për shkaqe tërësisht të qarta e që vështirë të hasen në zona të tjera të globit, faktorët e sipërpërmendur joekonomikë janë të pakuptimtë. Shqipëria dhe Kosova nuk kanë

nevojë të punojnë për të thelluar bashkëpunimin ekonomik, për hir të ndërtimit të marrëdhënieve më të qëndrueshme politike midis qeverive përkatëse. Kjo është realitet, së bashku me konsensusin e gjerë politik, shoqëror apo kulturor që ekziston në të dy anët e kufirit shqiptar.

Ajo që nevojitet në rastin e Kosovës dhe Shqipërisë, jashtë formave standarde të integrimit, është më tepër analiza e faktorëve të mirëfilltë ekonomikë, si dhe vëmendja ndaj realitetit që ekziston edhe përtej kufijve të Shqipërisë e Kosovës. Si element të rëndësishëm të kësaj pjese të analizës, nuk mund të shmangim faktin që ngritja dhe funksionimi i CEFTA-s, që prej themelimit të saj nga vendet e ish-Europës Lindore, tashmë anëtare të BE-së, e deri më sot, kur i njëjti model përdoret nga vendet e rajonit tonë, synon veçmas promovimit të bashkëpunimit ekonomik e tregtar mes vendeve pjesëmarrëse, edhe përgatitjen e tyre për një anëtarësim të plotë në Bashkimin European. Nga ky këndvështrim, funksionimi i CEFTA-s mund të shihet edhe si një lloj platforme testuese për ekonomitë pjesëmarrëse në të, për t'i përgatitur ato, sikurse dhe për të kuptuar aftësinë integruese të tyre për të qenë në të ardhmen pjesë e ekonomisë më të gjerë europiane. Nga kjo pikëpamje, në kushtet e mungesës së mëtejshme të progresit në kuadër të CEFTA-s dhe problemeve të diskutuara më sipër, mungon një zgjidhje e qartë se si mund të arrihet një thellim i mëtejshëm i CEFTA-s duke përdorur si bazë marrëveshjen ekzistuese.

Por nga ana tjetër, thellimi i bashkëpunimit rajonal, nuk mund të ndërtohet vetëm mbi pritshmëritë rreth integrimit të vendeve të rajonit në Bashkimin European. Jo vetëm që vendet e rajonit janë në faza të ndryshme në këtë proces, por për më tepër, rezultatet e këtij procesi mbeten në rastin më të mirë ende të pacaktuara në kohë. Po kështu, zhvillimet politike dhe historike të viteve të fundit dëshmojnë për pozicionime të ndryshme të shteteve të rajonit kundrejt këtij procesi të rëndësishëm integruar.

Propozimi i artikulluar gjatë kohëve të fundit mbi idenë e një bashkimi doganor mes vendeve të rajonit mund të tingëllojë politikisht tërheqës

kur ai lidhet me historinë e Bashkimit European, i cili siç u përmend, e ka zanafillën e tij me një bashkim doganor mes vendeve themeluese. Por veç kësaj ngjashmërie të largët, ka shumë arsye thelbësore që e zbehin dobinë e një modeli të tillë për vendet e rajonit dhe ngrenë pikëpyetje të rëndësishme mbi rolin e tij:

- **Së pari**, larmia e problemeve që ekzistojnë në bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar në rajon, përbëjnë sfida të rëndësishme të cilat nuk mund të zgjidhen apo anashkalohen përmes propozimit të modeleve të tjera të bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve, por veçse duke adresuar problemet dhe shkaqet e vërteta të tyre.
- **Së dyti**, mungon një analizë e plotë e kostove dhe përfitimeve për secilin vend, prej përdorimit të një modeli të tillë në rajon. Deri më sot, modeli i bashkimit doganor është prezantuar si një propozim politik dhe jo si një rrjedhojë natyrale e realitetit të zhvillimeve ekonomike në rajon.
- **Së treti**, vendet e rajonit janë në faza të ndryshme (anëtare / negociues për anëtare / jo anëtare) në raportin që kanë me Organizatën Botërore të Tregtisë dhe për shkak të implikimeve që burojnë nga marrëdhëniet me vendet e treta, do të ishte më e udhës që anëtarësimi në OBT nga të gjitha vendet të ishte një garanci në të ardhmen për një bashkim të mundshëm doganor.
- **Së katërti**, vendet e rajonit ndodhen në pozicione të ndryshme preferenciale tregtare kundrejt palëve të treta (p.sh., Shqipëria ka MTL me Turqinë apo Serbia ka MTL me Rusinë), të cilat në rastin e një bashkimi doganor mund të sjellin implikime negative dhe probleme të mëtejshme tregtare në administrimin e bashkimit doganor dhe mes vendeve të rajonit.
- **Së pesti**, vendet e rajonit aplikojnë sisteme tarifore dhe preferenciale krejt të ndryshme ndaj vendeve të treta dhe thelbi i bashkimit doganor, konsiston në unifikimin dhe përdorimin e një sistemi të përbashkët tarifor nga vendet pjesëmarrëse ndaj vendeve të

treta.

- **Së gjashti**, më lart u shpjegua se si përfitimet e vendeve nga CEFTA kanë rezultuar të pabalancuara për shkak të disbalancave në zhvillimet e ekonomive të tyre. Kalimi në një formë më të lartë integrimi mund të polarizojë edhe më tej këto disbalanca së bashku me pakënaqësitë dhe konfliktet mes vendeve.

- **Së shtati**, por edhe më e rëndësishme, funksionimi i bashkimit doganor në rajon do të kërkonte ngritjen e një sistemi mbi ndarjen e të ardhurave doganore mes vendeve pjesëmarrëse sikurse dhe fuqizimin e çështjeve ndërkufitare. Në kushtet e problematikës me kontrabandën e mallrave, mallrat ilegale, drogën apo shumë çështje të tjera, heqja e kufirit mes vendeve të rajonit, së paku në një periudhë afatmesme, tingëllon paksa utopike.

Së fundmi, nuk mund të mohohen dhe as nënvleftësohen synimet dhe shqetësimet e paraqitura në nivele politike mbi konfigurimin e këtij propozimi mbi bazën e reminishencave të së kaluarës një herë e përgjithmonë. Shqipëria ka arritur suksese të qenësishme në marrëdhëniet me vendet e rajonit dhe mund të luajë rol kyç në promovimin e investimeve në rajon, pa qenë e nevojshme përdorimi si shtojcë e artificave mbi modele të tejkaluara nga koha.

Prej së “njëjtës gjuhë” drejt një “gjuhe të përbashkët”.

E gjithë analiza tregon se, me gjithë përparimin e arritur deri më sot, Kosova dhe Shqipëria janë larg pritshmërive të shoqërisë shqiptare në të dy anët e kufirit shqiptar, si dhe kanë ende mundësi e tepër punë për të kryer për një integrim më të thelluar ekonomik mes tyre. Në një masë të madhe, mundësitë e integritit ekonomik kufizohen prej strukturave të ngjashme ekonomike dhe nivelit të zhvillimit ekonomik të dy shteteve shqiptare, por ky nuk është aspak një argument për të fajësuar të tjerët.

Përkundrazi, tregu i përbashkët mes dy vendeve duhet të shihet si

mundësi e bizneseve vendase për të konkurruar e për të qenë të afta të zgjerojnë aktivitetin në rajon, pikësëpari duke e përhapur aktivitetin e tyre në tregun e përbashkët shqiptar. E për të arritur këtu, kërkohet angazhim e koordinim i posaçëm institucional jo vetëm mes qeverive dhe institucioneve, por njëkohësisht edhe mes të gjithë bizneseve dhe forumeve të tyre, konsumatorëve, prodhuesve apo tregtarëve të të dy vendeve.

Shqipëria dhe Kosova, përfshirë dhe viset e tjera me popullsi shqiptare në rajon, mund të ecin së bashku në këtë drejtim pa kurrfarë droje se mund të sjellin shqetësime ndër fqinjët e tjerë të Ballkanit apo dhe më larg. Krijimi i një ambienti biznesi më produktiv i shërben gjithë rajonit dhe ndihmon konkurrencën e dobishme mes bizneseve të të gjithë vendeve. Arritja e këtij synimi nuk kërkon ndërtimin e një modeli tjetër për fuqizimin e marrëdhënieve ekonomike, kjo mund të arrihet edhe përmes zbatimit të marrëveshjeve që të dy shtetet kanë dhe është plotësisht i pajtueshëm me kërkesat e CEFTA-s.

Është e nevojshme që të dy vendet të punojnë fuqimisht për trajtimin e të gjitha propozimeve të përmendura më parë në pjesën 4 të këtij punimi, që synojnë rrëzimin e të gjitha barrierave, ndërtimin e urave lidhëse, shfrytëzimin e potencialeve dhe koordinimin e bashkëpunimit, sikurse dhe në fusha të tjera për të mundësuar kalimin real nga avantazhi i të pasurit të së njëjtës gjuhë, drejt të folurit të një gjuhe të përbashkët nga të gjitha institucionet, bizneset dhe organizatat shqipfolëse, si një faktor i rëndësishëm për të arritur drejt një tregu të përbashkët shqiptar.

Puna nën këtë këndvështrim do të largojë konfliktet e vogla për ndarjen e tregut sipas konceptit të konkurrimit të bizneseve me ato të anës tjetër të kufirit, dhe duke shuar kufijtë do të shtyjë bizneset të jenë më konkurruese me produkte, shërbime e strategji të reja në një treg të përbashkët, i cili u mundëson hapësirat për të zgjeruar aktivitetin edhe më tej në rajon. Veç në kushtet e një ambienti të tillë konkurrues, tregu i përbashkët do të forcojë premisat për më tepër investime nga bizneset vendase, duke u bërë njëkohësisht tërheqës për investimet e huaja.

Dhe së fundi, por aspak jo më e rëndësishme – ekonomia e Shqipërisë sikurse dhe ajo e Kosovës, dominohen në shumë sektorë nga kompani vendase apo të huaja me pozita kontrolluese në treg, gjë që jo vetëm shmang konkurrencën e sjell pasoja për konsumatorët, por njëkohësisht paraqet një ndër pengesat serioze të hyrjes në treg të bizneseve nga të dy vendet. Hapja e tregut të brendshëm, promovimi i konkurrencës së shëndetshme për bizneset vendase dhe të huaja dhe reduktimi i pozitive oligopoliste e klienteliste, si dhe mbështetja e produktivitetit të kompanive që zgjerojnë gjeografikisht aktivitetin në rajon, mbetet çelës parësor për suksesin e bizneseve shqiptare në të ardhmen.

Dominimi

Ekonomia e Shqipërisë sikurse dhe ajo e Kosovës, dominohen në shumë sektorë nga kompani vendase apo të huaja me pozita kontrolluese në treg, gjë që jo vetëm shmang konkurrencën e sjell pasoja për konsumatorët, por njëkohësisht paraqet një ndër pengesat serioze të hyrjes në treg të bizneseve nga të dy vendet.